



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 21 tetor 2016, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Puhie Demaku.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Aida Dërguti, deputete; Eugen Cakolli, KDI; Blerta Bejtullahu, EU Office; Dren Ajeti, GLPS; Gurjeta Zeka, Naim Jakaj- LVV; Taulant Salihu, KREK dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Diskutim lidhur me Draft-deklaratën e datës 18.10.2016.

Elmi Reçica, theksoi se në takimin që ka pasur Komisioni me Kryetarin e Kuvendit, më 18.10.2016, temë e diskutimit ka qenë puna e Komisionit për Punë të Jashtme dhe diplomacia parlamentare. Në këtë takim, tha se ka lindur ideja për nxjerrjen e një deklarate të përbashkët nga grupet parlamentare, anëtarët e të cilave janë të përfshirë në Komision dhe që ka të bëjë me liberalizimin e vizave dhe demarkacionin. Ai lexoi Draft-deklaratën e propozuar me tekstin si vijon:

Ne, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të përkushtuar për integrimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian, përmes fuqizimit të demokracisë, sundimit të ligjit, lirive dhe të drejtave të njeriut;

Të përkushtuar për fqinjësi të mirë, paqe, stabilitet dhe bashkëpunim të mirë me Malin e Zi dhe me të gjitha vendet fqinje;

Pavarësisht dallimeve që kanë mbi mënyrën e shënjitimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, koalicioni qeverisës dhe opozita qëndrojnë të bashkuar në qëllimin, që ky proces të përmbyllet sa më shpejt që është e mundur;

Duke marrë për bazë këtë konsensus parimor, ne si përfaqësues të popullit, kërkojmë mirëkuptimin e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian që qytetarëve të Kosovës t'ju njihet e drejta e lëvizjes së lirë në zonën Shengen;

Ju njoftojmë se institucionet e Kosovës i kanë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara, që dalin nga udhërrëfyesi për liberalizim të vizave.

Zafir Berisha, tha se ishte në dijeni se kjo deklaratë do të jetë ide e Komisionit për Punë të Jashtme dhe se nuk kishte njohuri se e njëjta do të duhej të diskutohej edhe nga shefat e grupeve parlamentare. Nëse do të duhej të trajtohej si deklaratë e grupeve parlamentare, atëherë për shqyrtimin e saj do të duhej të ishte një përbërje tjetër, tha z. Berisha. Lidhur me Draft-deklaratën, propozoi që paragrafi i fundit i saj, të fshihet. Po ashtu, propozoi që Draft-deklarata të plotësohet me një paragraf të ri, ku do të potencohet roli i opozitës, me tekstin si vijon:

Opozita garanton se do ta japë kontributin e vet në zgjidhjen e këtij kontesti mbi faktet dhe argumentet që i posedojnë, në të njëjtën kohë është zotuar që çështjen e demarkacionit me Malin e Zi ta zgjidhë përmes gjuhës politike dhe diplomatike, ku nuk do të dëmtohet integriteti territorial i asnjërit shtet.

Aida Dërguti, lidhur me çështjen e diskutimit lidhur me Draft-deklaratën, tha se e sheh si një duplikim të procesit, të cilin e ka iniciuar z. Rashiti, nga Grupi për Hulumtimin e Politikave të Ballkanit. Sipas saj, kjo deklaratë mund të jetë e paqëndrueshme, nëse nuk ka konsensus. Duke u ndërlidhur me paragrafin tre të Draft-deklaratës, tha se është kontradiktor dhe se duhet të precizohet ajo për çfarë nuk pajtohem, e ajo është marrëveshja aktuale. Po ashtu, znj. Dërguti tha se paragrafi i fundit i Draft-deklaratës është i paqëndrueshëm. Si formë e propozimeve, tha se mund t'ia shtojmë kësaj draft-Deklarate, komentet të cilat Lëvizja VV, i ka ofruar tek “Ballkan Policies Group”. Draft-deklaratës, tha se duhet t'i shtohet një fjali që precizon se duhet të punojmë së bashku, me qëllim të arritjes së konsensusit, si dhe të shqyrtohen parimet mbi të cilat ne dëshirojmë të arrijmë me konsensus.

Elmi Reçica, tha se ne kemi menduar të dalim me një qëndrim të përbashkët, dhe pastaj si bartës të deklaratës, të formojmë grupe punuese të caktuara dhe të bëjmë vizita në qendra të ndryshme, si në Bruksel, Paris etj. Çështja e demarkacionit me Malin e Zi kërkoi, që të mos jetë pengesë momentale për liberalizimin e vizave, ngase do të punojmë si pozitë e opozitë dhe do të gjejmë një zgjidhje.

Pal Lekaj, lidhur me Draft-deklaratën, tha se jemi munduar të japim kontributin tonë dhe të marrim edhe qëndrimin e subjektit politik. Pos që jemi të interesuar dhe kemi një konsensus, që qytetarët tanë të lëvizin lirshëm, kemi edhe dallime mes vete, sa i përket çështjes së demarkacionit, tha z. Lekaj, duke shtuar se është e padrejtë që i është kushtëzuar demarkacioni Kosovës, për liberalizim të vizave. Në Draft-deklaratë, në paragrafin tre të saj, propozoi që fjalët: “*pavarësisht dallimeve që kemi*”, të zëvendësohen me fjalët: “*me procesin*”, po ashtu edhe fjalët: “*të përmbyllen*”, të zëvendësohen me fjalët “*të zgjidhen*”. Paragrafi i fundit propozoi të fshihet, ndërsa pas paragrafit tre, propozoi që të shtohen dy paragrafë si vijon:

Ne, grupet parlamentare, garantojmë se do të japim kontributin tonë në zgjidhjen e këtij kontesti, përmes rishikimit e mbi bazën e fakteve dhe argumenteve që janë paraqitur, dhe në të njëjtën kohë, jemi të përcaktuar që çështja e demarkacionit me Malin e Zi, të zgjidhet përmes rrugës politike, diplomatike e ligjore, ku nuk do të dëmtohet integriteti territorial i asnjërit shtet.

Si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, jemi të vendosur që të vazhdojmë angazhimin e plotë institucional, për forcimin e rendit dhe ligjit, luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Zafir Berisha, theksoi se ideja për nxjerrjen e deklaratës është rezultat i procesit dhe afatizimit kohor. Sipas tij, tendenca e Komisionit nuk ka të bëjë me përafrim të qëndrimeve që janë diametralisht të kundërta, por në njëfarë forme partitë politike parlamentare të garantojnë, se nuk janë të interesuara që me mjete jopolitike ta zgjidhin këtë problem. Nëse ne dëshirojmë të dalim me një qëndrim unik karshi mekanizmave ndërkombëtar; nuk nënkupton se ne, në këtë rast, po lëshojmë pe për një çështje, të cilën e kemi mbrojtur me fakte e argumente. Ne nuk i kemi ndryshuar qëndrimet tona lidhur me koalicionin qeverisës, i cili e ka sjellë në këtë gjendje perspektivën e qytetarëve, duke u treguar të njëanshëm dhe kokëfortë dhe duke menduar se me arrogancën e votave, mund t'i kalojë disa procese mbi faktet e argumentet që ekzistojnë.

Ismet Beqiri, tha se një deklaratë të tillë e kuptojmë si shprehje e vullnetit të mirë dhe se i kanë të qarta qëndrimet e opozitës, sikurse që janë të qarta edhe qëndrimet e pozitës. Lidhur me Draft-deklaratën, tha se është shumë e balancuar me një formulim që nuk e lëndon askënd. Nëse ne do të hyjmë në ndryshim të këtij drafti, nuk do të mund ta nxjerrim deklaratën.

Blerta Deliu-Kodra, theksoi se Draft-deklarata është shprehje e vullnetit të mirë të deputetëve, dhe se nuk i kanë diskutuar dallimet mes subjekteve politike, sepse është evidente se ekzistojnë dallime në këtë çështje. Në të tri draftet e propozuara, ajo që është pozitive, tha se është potencimi se procesi i demarkacionit me Malin e Zi, të zgjidhet përmes rrugëve politike, diplomatike, ligjore dhe institucionale.

Aida Dërguti, theksoi se nuk ka kuptim që të diskutohet Draft-deklarata, nëse po kërkohet që ky tekst të mos ndryshohet. Dallimet në këtë proces janë pikërisht ato, që e kanë pamundësuar përmbylljen e këtij procesi që një vit, tha znj. Dërguti.

Ismet Beqiri, tha se z. Lekaj dhe z. Berisha kanë qenë në takim dhe dihet se cilat janë dallimet tona, por duhet ta gjejmë një formulim, i cili e shpreh vullnetin tonë të mirë. Z. Beqiri shtoi se, ne mund të debatojmë për fjalët e caktuara, por nuk ka më qartë se kur thuhet: *“pavarësisht dallimeve, ne jemi të interesuar ta zgjidhim këtë çështje.”*

Pal Lekaj, tha se nuk është korrekte, nëse nuk merren parasysh propozimet tona, meqë Draft-deklarata nuk është e përbashkët, prandaj edhe janë këto dallime. Ne nuk po e hedhim poshtë Draft-deklaratën, mirëpo kemi bërë disa shtesa dhe për to, mund të diskutojmë. Më tej, shtoi se jemi të interesuar t'i kontribuojmë çështjes, meqë është urgjente dhe atë që kemi cekur para mediave, jemi munduar që ta inkorporojmë edhe në deklaratë.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se të gjitha diskutimet me Kryetarin e Kuvendit, janë pjesë e kësaj deklarate dhe se nuk ka çfarë të ndryshohet. Sa i përket liberalizimit të vizave, tha se në janar të vitit

2016, në Bruksel na është thënë se janë përmbushur të gjitha kriteret sipas udhërrëfyesit dhe demarkacioni ka lindur si kriter shtesë nga situata e krijuar nga vetë politikanët në Kuvendin e Kosovës. Shprehu mendimin se me një deklaratë të tillë, ne i japim BE-së një mesazh të qartë se jemi të unifikuar për të ecur drejt proceseve integruese të vendit.

Qerim Bajrami, fillimisht, tha se është shumë e rëndësishme që kjo temë po shqyrtohet në Kuvend, ngase një vendim i tillë nuk kërkohet nga asnjë organizatë tjetër, pos nga Kuvendi. Njoftoi se ka kërkuar që z. Reshiti, t'i ftojë në forum edhe përfaqësuesit e Grupit Parlamentar 6+, por nuk janë ftuar dhe bëri me dije se edhe ky grup parlamentar i ka votat e tij në Kuvend. Bashkësia ndërkombëtare kërkon që ky Kuvend të deklarohet se a dëshiron ta votojë demarkacionin apo jo, dhe se cilin vendim do ta sjellë Qeveria lidhur me demarkacionin. Esenca e demarkacionit ka qenë dhe ka mbetur që ne si Kuvend, të deklarohemi se a dëshirojmë që kjo çështje të zgjidhet sa më parë, në mënyrë demokratike me Malin e Zi. Ne jemi të përcaktuar që këtë çështje ta zgjidhim sa më parë, dhe nëse ka gabime, jemi të gatshëm të bisedojmë për to.

Aida Dërguti, propozoi që në Draft-deklaratë të shtohet fjalia: *“subjektet politike parlamentare të punojnë së bashku, me qëllimin e arritjes së konsensusit”*. Propozimi tjetër i znj. Dërguti, është: *“Palët pajtohen që shqyrtimi i marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, të jetë në përputhje me parimin e së drejtës publike ndërkombëtare, integritetin territorial të Kosovës, ligjeve të Kosovës, interesave të vendit dhe parimin e respektimit reciprok në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, për fqinjësi të mirë”*. Duke iu referuar Draft-deklaratës, tha se nëse është vendosur që vetëm versionin i juaj të shkojë dhe të mos përfshihen propozimet tona, atëherë nuk ka kuptim të kërkonin që të jemi pjesë e kësaj deklarate.

Pal Lekaj, tha se nëse nuk dëshironi t'i qaseni propozimeve tona, atëherë nuk kemi se çfarë të diskutojmë, sepse ashtu siç keni ofruar edhe ju, edhe ne kemi ofruar një draft- dokument dhe dëshirojmë që të kontribuojmë për të mirën qytetarëve dhe të vendit.

Elmi Reçica, shtoi se ne e kemi një qëndrim si pozitiv, ndërsa edhe opozita e ka qëndrimin e saj, por tanimë jemi ngritur mbi dallimet tona dhe po dëshirojmë që të dërgojmë një mesazh dhe të kërkojmë nga vendet e BE-së, që të na mundësojnë liberalizimin e vizave.

Zafir Berisha, nga takimi i Komisionit me Kryetarin e Kuvendit, tha se disa nga qëndrimet tona janë të përfshira në këtë deklaratë, por nuk janë të mjaftueshme, sepse drafti është i përgjithësuar. Shprehu mendimin se me kontributin e tyre, japin një sinjal pozitiv për miqtë ndërkombëtarë, se kur është në pyetje sovraniteti i vendit, janë bashkë, pa e cenuar asnjë shtet fqinj.

Propozoi që në tekstin e deklaratës, të shtohet teksti: *“në emër të subjekteve politike shprehim gatishmërinë dhe zotohemi që proceset do të zgjidhen me mjete politike, sipas ligjit dhe Kushtetues së vendit”*.

Ismet Beqiri, duke iu referuar propozimit të z. Lekaj: *“Ne, grupet parlamentare garantojmë se do të japim kontributin tonë në zgjidhjen e këtij kontesti”*, propozoi të ndryshohet si vijon: *“në zgjidhjen e kësaj çështjeje ose demarkacionit, mbi bazën e fakteve dhe argumenteve që i ofrojnë pozita dhe opozita”*. Lidhur me këtë propozim, tha se nuk lëndohet as pozita, as opozita.

Pal Lekaj, sa i përket propozimit të z. Beqiri, tha se ne kemi kërkuar dhe kemi ofruar argumente lidhur me demarkacionin, por deri më tani nuk jemi ulur në tavolinë dhe kemi thënë se pa u rishikuar ky proces, nuk ka zgjidhje. Z. Lekaj tha se nëse dëshirojmë konsensus, duhet të rishikohet ai dokument, dhe në bazë të argumenteve dhe fakteve të dyanshme, të ofrohet një zgjidhje.

Elmi Reçica, tha se jemi dakorduar, që të theksojmë se kemi dallime, por nuk jemi dakorduar që do të bëjmë rishikime. Propozoi që Draft-deklarata t'i dërgohet për shqyrtim Kryesisë së Kuvendit dhe grupeve parlamentare, duke shtuar se Komisioni është bartës i kësaj deklarate dhe kësaj të përpiqemi për t'i hapur rrugë vetës, që të kemi mundësi për lobim, për liberalizim të vizave.

Pal Lekaj, propozoi që edhe vërejtjet e opozitës t'i bashkëngjitet Draft-deklaratës dhe t'i dërgohet Kryesisë.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisionit nxori këtë

Përfundim

I propozohet Kryesisë së Kuvendit, që të harmonizojë Draft-deklaratën, me plotësim-ndryshimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, AAK-së dhe NISMA-s.

Mbledhja përfundoi në orën 16:25.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Elmi Reçica